



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

## KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



### Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. \_\_\_\_\_/2021

Datë: 30.04.2021

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 18 pika C të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.011-10 i miratuar 16.12.2008, dhe në nenin 6 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 dhe paragrafit 9 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucioneve Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese Para universitarë në Republikën e Kosovës, Procedurat e zgjedhjes dhe të emërimit, përfundimit të Kontratës dhe emetimit të përkohshëm, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2021 pas diskutimit lidhur me pikën 9 të rendit të ditës: Kërkesa për caktimin e anëtarëve të Komisionit rekrutues për Pozitat e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, e miratoi këtë:

### V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e DKA-së për formimin e komisionit të rekrutimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve në shkollat e Komunës së Gjakovës, sipas Konkursit me nr. 01-111/01-5889 të datës 15.03.2021.

2. Anëtarët e emëruar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës me propozimin e DKA-së janë :

1. znj. Flutura Këpuska, Zyrtare e Arsimit të mesëm të Lartë në Komunën e Gjakovës.
2. z. Pal Çuni, Drejtor i shkolës " Gjergj Fishta " në Bishtazhin .

3. Anëtar i tretë i këtij Komisioni zgjidhet nga MASH-ti, ashtu siç është paraparë në Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020 .

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

5. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë Komunale për Arsim .
- Anëtarëve të Komisionit .
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shala